



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

RAPORT

MBI VEPRIMTARINË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

SHKURT-KORRIK 2020

TIRANË

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE	3
2.	ÇËSHITJE QË TRAJTOHEN NË RAPORT	4
3.	RREGULLIMI I VEPRIMTARISË SË ILD-SË	4
4.	AKTE TË MIRATUARA APO VEPRIMET INSTITUCIONALE TË NDËRMARRA	5
	4.1 Objekti i veprimtarisë së ILD-së dhe fazat e trajtimit të ankesave	
	4.2 Situata aktuale e shqyrtimit të ankesave	
	4.3 Organizimi i brendshëm	
5.	ORGANIKA E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË	10
	5.1 Struktura e brendshme dhe rekrutimet	
	5.2 Emërimet të inspektorëve	
6.	MENAXHIMI I FONDEVE	13
7.	BASHKËPUNIME ME INSTITUCIONE TË TJERA APO MEKANIZMA NDËRKOMBËTARË	15
8.	KONKLUZIONE	16

1. HYRJE

Reforma në Drejtësi, ndër reformat më të mëdha në këto 30 vite demokraci të shtetit shqiptar, është panoramë e një sistemi drejtësie tërësisht të ri, me ndikim të drejtëpërdrejtë në forcimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Kjo reformë, u konceptua dhe u vu në zbatim jo vetëm për të përmirësuar në mënyrë cilësore sistemin e drejtësisë, por, mbi të gjitha, për t'ju përgjigjur shqetësimit të qytetarëve shqiptarë, me qëllimin e vetëm krijimin e një sistemi drejtësie me institucione të qeverisjes profesionale, meritokratike, të pakapura nga politika e korupsioni si dhe të përgjegjshme përpara ligjit.

Si rezultat i zbatimit të Reformës në Drejtësi, erdhi dhe krijimi i institucioneve tepër të rëndësishme, me natyrë të përhershme dhe me detyra e funksione të qarta kushtetuese dhe ligjore.

Një nga këto institucione është dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, një institucion i ri kushtetues dhe ligjor, i cili u konstitua në datën 01.02.2020 pas zgjedhjes së z.Artur Metani Inspektor i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 2/2020, datë 20.01.2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë".

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është institucioni më i ri që plotëson të gjithë arkitekturën e sistemit të ri të drejtësisë, përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është gjithashtu përgjegjës për inspektimin institucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë.

Parimet, procedurat dhe rregulloret e nevojshme për kryerjen e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, statusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe statusin e inspektorëve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë parashikuar në Kreun IV, nenet 193-215 të Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar.

Në kuadër të detyrimit ligjor mbi raportimin institucional, bazuar në nenin 204, pika 1, gërma "d", e ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar dhe Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 134/2018 "Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik", përcillet ky raport përmbledhës mbi punën e kryer nga ILD për aq sa është bërë e mundur, kushtëzuar kjo nga situata dhe kufizimet e krijuara nga pandemia botërore si dhe problematikat e konstatuara nga institucioni që nga krijimi i tij e deri në muajin Korrik 2020.

Gjithashtu, në realizimin e detyrave të ILD-së duhet mbajtur në konsideratë edhe fakti i mangësive të theksuara në burime njerëzore apo mungesën e infrastrukturës dhe mjediseve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së institucionit.

2. ÇËSHTJE QË TRAJTOHEN NË RAPORT

Në këtë raport Shkurt-Korrik 2020, jepet informacion i detajuar mbi veprimtarinë e ILD-së.

Në periudhën objekt raportimi, në mënyrë të përmbledhur, ILD ka trajtuar çështje që lidhen kryesisht me:

- a) rregullimin e veprimtarisë së tij ligjore, strukturore dhe fizike;
- b) aktet e miratuara dhe veprimet institucionale të ndërmarra;
- c) organikën dhe plotësimin e vendeve vakante;
- d) menaxhimin e fondeve;
- e) bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe ndërkombëtare.

3. RREGULLIMI I VEPRIMTARISË SË ILD-SË

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- VKM nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.536, datë 25.7.2019 “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”;
- Vendimi nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 24.06.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë të godinës së ish- Ministrisë së Integritimit Evropian” ;

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar **Urdhrin nr. 7 datë 04.03.2020** “Për miratimin e rregullores për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë, për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, bashkëlidhur të cilit është dhe Shtojca nr. 1 “Kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e pikëzimit të kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Gjithashtu, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë janë përgatitur edhe aktet nënligjore për organizimin e brendshëm të Zyrës së ILD-së, të cilat kanë nevojë të miratohen pas emërimit në detyrë të trupës së inspektorëve.

4. AKTE TE MIRATUARA APO VEPRIME INSTITUCIONALE TË NDËRMARRA

4.1 Objekti i veprimtarisë së ILD-së dhe fazat e trajtimit të ankesave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Pika 2 e nenit 194 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, përcakton si më poshtë:

2. Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Inspektori vihet në lëvizje bazuar në:

a) ankimin me shkrim çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar;

b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë;

c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm;

ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore;

dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore

Nga momenti i depozitimit të ankesës nga subjektet e sipërcituara, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndjek fazat e mëposhtme:

➤ Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme dhe pas shqyrtimit fillestar të ankesës, nëse kjo e fundit nuk përmbush një ose më shumë kriteret të parashikuara

në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos arkivimin e ankesës duke njoftuar ankuesin dhe magjistratin brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshillin përkatës (KLGJ ose KLP), brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në rast se ankesa përmbush kritere të përcaktuara në ligj si dhe vlerësohet se nga faktet e parashtruara në ankesë dhe pretendimet e ngritura në të, ka vend për verifikimin e tyre, atëherë Inspektori i Lartë vendos verifikimin e ankesës sipas nenit 121 pika 2, gërma b), e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

➤ **Verifikimi i ankesës**

Në rastet kur vendoset verifikimi i ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t’i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar, si dhe mund të marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Pas administrimit të dokumentacionit, në kuadër të verifikimit të shkeljes së pretenduar, në rast se konstatohet se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet dhe vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa.

Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill (KLGJ ose KLP), brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Nëse, pas verifikimit, ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura gjatë verifikimit, që justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit apo magjistratëve ndaj të cilëve ngrihen pretendimet nga ankuesi, Inspektori i Lartë fillon hetimin.

➤ **Hetimi disiplinor**

Hetimi disiplinor është një ndër tre fazat e shqyrtimit të ankesës e cila nis:

- Me nismë të ankuesit nëse, gjatë verifikimit të ankesës, konstatohet apo ka dyshime se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të cilat justifikojnë dhe fillimin e hetimit. Gjatë hetimit disiplinor behët një hetim i plotë dhe i gjithanshëm lidhur me dyshimet e ngritura gjatë fazës së verifikimit të ankesës.

- Me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në të dhëna thelbësore mbi faktet që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Në rast se pas kryerjes së hetimit dhe përfundimit të procedurave përkatëse, Inspektori i Lartë vlerëson se nuk provohet shkelja apo pretendimet janë të pabazuara në ligj dhe në provat e mbledhura, vendos mbylljen e hetimit disiplinor bazuar në nenin 134, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, atëherë Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon **procedimin disiplinor**, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore pranë Këshillit përkatës (KLGJ ose KLP).

➤ **Procedimi disiplinor**

Pas paraqitjes së raportit të hetimit nga Inspektori i Lartë pranë Këshillit përkatës, ky i fundit cakton datë e seancës dhe njofton palët brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli:

- a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;
- b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati kanë të drejtë të ankimojnë, respektivisht, çdo vendim të Këshillit për çështjet disiplinore dhe vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente.

4.2 Situata aktuale e shqyrtimit të ankesave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrës së tij, bazuar në nenin 119 e vijues, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, dhe Ministrisë së Drejtësisë të dërgohen pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

- Ankesat e depozituara nga çdo person fizik, ose juridik lidhur me pretendimin për shkeljet e kryera nga ana e magjistratëve;
- Çdo dosje disiplinore në proces hetimi;
- Çdo problematikë të konstatuar që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Çdo çështje lidhur me inspektimet tematike dhe institucionale sipas kërkesave të nenit 194, pika 4, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën Shkurt – Korrik 2020, janë depozituar:

- **757 ankesa** të marra nga KLGJ si ankesa të prapambetura;
- **140 ankesa** të depozituara nga institucione të tjera (KLP, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Presidenti i Republikës, SPAK, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, gjykata, bashki etj)

Gjithashtu, pranë Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë janë depozituar:

- **442 ankesa** nga qytetarët.

Bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj.

Në zbatim të kësaj dispozite, për periudhën Shkurt- Korrik 2020, janë kryer:

- **442 konfirmime** mbi ankesat e depozituara nga qytetarët;
- **746 konfirmime** mbi ankesat e prapambetura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- **87 konfirmime** mbi ankesat e depozituara nga institucione të tjera.

Bazuar në nenet 121, pika 2, gërma b) dhe 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, lidhur me verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar, përgjatë periudhës Janar-Korrik 2020, janë miratuar:

- **17 vendime** për verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar;
- **33 vendime** për arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar;
- **33 njoftime** për vendimet e arkivimit të ankesave;
- **5 vendime** arkivimi pas verifikimit të ankesës;
- **27 kërkesa** drejtuar gjykatave apo prokurorëve, mbi informacione ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve të kërkuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kuadër të verifikimit të ankesave;

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenet 194/3 dhe 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar **6 vendime për fillimin e hetimit disiplinor**, konkretisht:

- Vendimi nr. 313/7 prot., datë 02.04.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit M.K”
- Vendimi nr. 251/11 prot., datë 22.05.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurores E.K”;

- Vendimi nr. 705/1 prot., datë 22.05.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares E.H”;
- Vendimi nr. 664/4 prot., datë 07.07. 2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj gjyqtarit SH.M”;
- Vendimi nr. 1751 prot., datë 16.07.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj gjyqtares E.H”;
- Vendimi nr. 1752 prot., datë 16.07. 2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorit B.M”;
- Vendimi nr. 705/12 prot., datë 17.07.2020 “Për pezullim hetimi disiplinor ndaj gjyqtares E.H”;
- Vendimi nr. 251/29 prot, datë 21.07.2020 “Për mbylljen e hetimit disiplinor ndaj prokurores E.K”;

Nga këto hetime disiplinore të kryera janë dërguar:

- 2 kërkesa për procedim disiplinor për një magjistrat gjyqtar dhe një magjistrat prokuror pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në pikën 4 të nenit 194 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kryen dhe inspektive institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrisë të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektiveve.

Në zbatim të kësaj dispozite janë miratuar:


- Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirimin me Kusht”;
- Vendim Nr. 1/1 datë 20.02.2020 “Për shtimin e objektit të inspektimit tematik të caktuar me vendimin nr. 1 datë 11.02.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

Duhet të theksohet se lidhur me të drejtën e ankimit të ushtruar nga ankuesit pranë KLGJ, ndaj vendimeve të miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri tani janë dërguar nga Zyra e ILD-së **10 praktika pranë KLGJ-së**, të kërkuara nga kjo e fundit, në kuadër të shqyrtimit të ankimit ndaj vendimeve të ILD-së.

Të dhënat e mësipërme i gjeni në mënyrë të përmbledhur në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij raporti si dhe në grafikun e mëposhtëm.

SHQYRTIMI I ANKESAVE

■ SHKURT ■ MARS ■ PRILL ■ MAJ ■ QERSHOR ■ KORRIK



4.3 Organizimi i brendshëm

Sa i përket organizimit të brendshëm të ILD-së, në zbatim të nenit 204 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën Shkurt-Korrik 2020, ka miratuar :

- **22 urdhëra** konkretisht:

➤ **Urdhër nr. 7 datë 04.03.2020** “Për miratimin e rregullores për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë, për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

➤ **Urdhër nr. 14, datë 23.04.2020** “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

➤ **5 urdhëra** për ngritje të komisioneve, konkretisht:

a) Urdhër Nr. 18 datë 05.05.2020, “Për ngritjen e komisionit për marrjen e automjetit me targa AA 561 VV, transferuar pa pagesë nga Avokatura e Shtetit tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë”;

b) Urdhër Nr. 11 datë 04.03.2020, “Për ngritjen e komisionit të brendshëm për lëvizjen paralele”;

c) Urdhër Nr.10 datë 04.03.2020, “Për ngritjen e komitetit të pranimit për lëvizjen paralele”;

d) Urdhër Nr. 16 datë 05.05.2020 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël”;

e) Urdhër nr. 22 datë 24.06.2020 “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit”.

➤ **12 urdhëra** në kuadër të zbatimit të ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

➤ **Urdhër** “Për miratimin e kriterëve dhe kërkesave të pozicioneve të punës së strukturës dhe organikës së përkohshme të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”;

➤ **Urdhër** “Për prokurimin me vlerë të vogël”;

➤ **Urdhër** “Për përcaktimin e Administratorit të Sistemit të Autoritetit Kontraktor”;

• **8 vendime**, konkretisht:

➤ Vendim nr. 2 datë 11.03.2020 “Mbi nxjerrjen e aktit të emërimit në detyrë dhe fillimin e marrëdhënieve financiare”;

➤ Vendim nr. 4 datë 24.03.2020 “Mbi fillimin e marrëdhënieve financiare”;

➤ Vendim nr. 5 datë 24.03.2020 “Mbi nxjerrjen e aktit të emërimit në detyrë”;

➤ Vendim nr. 7 datë 25.03.2020 “Mbi nxjerrjen e aktit të emërimit në detyrë”;

➤ Vendim nr. 9 datë 30.03.2020 “Mbi nxjerrjen e aktit të emërimit në detyrë”;

➤ Vendim nr. 11 datë 30.03.2020 “Mbi nxjerrjen e aktit të emërimit në detyrë”;

➤ Vendim nr. 13 datë 06.04.2020 “Mbi nxjerrjen e aktit të emërimit në detyrë”;

➤ Vendim nr. 15 datë 30.04.2020 “Mbi nxjerrjen e aktit të emërimit në detyrë”;

5. ORGANIKA E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

5.1 Struktura e brendshme dhe rekrutimet

Me qëllim fillimin sa më parë të veprimtarisë së institucionit në mbështetje të nenit 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me Urdhrin nr.1, datë 07.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së përkohshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, miratoi strukturën e përkohshme të institucionit me 40 punonjës.

Bazuar në këtë strukturë, u hartuan përshkrimet e pozicioneve të punës dhe më datë 08.02.2020 u shpallën 27 pozicione vakante.

Në të njëjtën kohë, ILD hartoi dhe strukturën përfundimtare, e cila sipas nenit 197, pika 4, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, u dërgua në datën 06.03.2020 për miratim pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe u miratua nga ky i fundit me vendimin nr. 28/2020, datë 18.06.2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”¹.

Deri në datën 13 Mars 2020, ditën kur u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore, institucioni i ILD-së arriti të përfundojë 8 procedura rekrutimi pasi procedurat e tjera u pezulluan për shkak të masave të marra nga Qeveria si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia dhe anulimit të të gjitha procedurave për rekrutimet në shërbimin civil.

Për shkak të kohëzgjatjes së pezullimit të procedurave të rekrutimit si dhe duke marrë në konsideratë faktin se Kuvendi i Shqipërisë ishte në fazën e miratimit të strukturës përfundimtare të propozuar nga ILD, në respektim të parimeve të ekonomisë administrative, të kryerjes në të njëjtën kohë të të gjitha procedurave të rekrutimit për të shmangur mbivendosje të zhvillimit të procedurave të ndryshme për të njëjtin pozicion pune, ILD anuloi procedurat e shpallura dhe vendosi t’i rishpallë sërish ato sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil“ i ndryshuar, në përputhje me strukturën, organikën dhe përshkrimet e reja të punës të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në zbatim të vendimit nr. 28/2020, datë 18.06.2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të Kuvendit të Shqipërisë, të gjitha procedurat për rekrutimin e vendeve vakante janë shpallur më datë 25 Qershor 2020².

Aktualisht, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është në fazën e konstatimit dhe verifikimit të dosjeve të kandidatëve, proces ky i cili shoqërohet menjëherë me shpalljet e njoftimeve përkatëse në faqen zyrtare të ILD-së, në kuadër të transparencës ndaj publikut.

Lidhur me emërimet për punonjësit e administratës pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës Shkurt-Korrik 2020, janë kryer përkatësisht:

- **12 emërimet pjesë e shërbimit civil**, nga të cilët:
 - 6 niveli specialist,
 - 2 nivel i ulët drejtues;
 - 1 nivel i mesëm drejtues;
 - 3 ndihmës inspektorë;

- **5 emërimet** si pjesë e kabinetit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga të cilët:
 - 4 këshilltar;
 - 1 sekretare;

¹ Vendimi do ti bashkëlidhet këtij raporti në aneksin 1.

² Të gjitha vendet vakante të shpallura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë janë të publikuara në faqen zyrtare www.ild.al.

- **1 emërim** për staf mbështetës;
- **7 punonjës** me kontratë të përkohshme, bazuar në VKM nr. 47, datë 22.01.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Në kuadër të zbatimit të detyrimit ligjor mbi vlerësimin e punës së kryer nga punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil, janë përfunduar dhe miratuar **8 vlerësime** mbi punën e kryer prej tyre.

Të gjitha procedurat e rekrutimit të vendeve vakante me kontratë të përhershme të shpallura nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës Prill-Maj kanë qenë të pezulluara bazuar në Urdhrin nr. 351, datë 29.05.2020 “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5.2 Emërimet të inspektorëve

Sa i përket emërimeve për pozicionin inspektor pranë ILD-së, bazuar në nenin 209 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, jo më pak se gjysma e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë magjistratë, të cilët komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Pjesa tjetër e inspektorëve emërohen nga Inspektori I Lartë i Drejtësisë sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 69, datë 07.02.2020, ka komanduar përkohësisht si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një periudhë 6 mujore magjistraten znj. Marsela Pepi.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e datës 26.02.2020, ka vendosur të hapë procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione inspektor magjistrat, në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pozicion për të cilin nuk ka patur asnjë kandidaturë.

Më datë 10.07.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rihapur serish procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin inspektor magjistrat pranë Zyrës së ILD-së dhe deri tani rezulton se nuk ka asnjë kandidaturë të paraqitur.

Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin nr. 37, datë 05.02.2020, ka shpallur fillimin e procedurës për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes procedurës së komandimit, dhe me vendimin Nr. 77, datë 04.03.2020, ka komanduar Znj. Mirela Kapo, prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Krujë, në pozicionin e ndihmës magjistratit (këshilltar) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka pranuar **6 kandidatura** nga prokurorë për pozicionin inspektor magjistrat dhe aktualisht është në proces të vlerësimit të kandidaturave të paraqitura.

Sa i përket rekrutimit të inspektorëve jomagjistratë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.536, datë 25.7.2019 “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka shpallur procedurën për pozicionin e Inspektorit jo magjistrat fillimisht **për 6 vende**.

Aktualisht, ILD është në pritje të informacioneve nga institucione të tjera në kuadër të procesit të verifikimit të figurës, integritetit dhe të pasurisë së kandidatëve në fjalë.

6. MENAXHIMI I FONDEVE

Lidhur me menaxhimin e fondeve nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbështetur në Ligjin 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar, në zbatim të Udhëzimit nr.9/2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe Udhëzimit plotësues nr.2 dt.20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, më poshtë ju informojmë mbi planifikimin e fondeve buxhetore për vitin 2020 dhe realizimin e tyre për periudhën Janar-Korrik 2020; Mbështetur në Ligjin 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar, në zbatim të Udhëzimit nr.9/2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe Udhëzimit plotësues nr.2 dt.20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, më poshtë ju informojmë mbi planifikimin e fondeve buxhetore për vitin 2020 dhe realizimin e tyre për periudhën janar-qershor 2020:

Me ligjin 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, buxheti i miratuar për institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është 100.2 milionë lekë, (me financim të brendshëm), nga i cili:

- Shpenzime korente (paga, sigurime dhe shpenz.operative) 93.2 milionë lekë
- Shpenzime kapitale (investime) 7 milionë lekë

Në zbatim të Aktit Normativ nr.15 dt.15.04.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” të ndryshuar, në buxhetin e rishikuar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, grupi “Shpenzime korente”, është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë pakësimi i fondeve në **vlerën 14 milionë lekë**, e konkretisht

- Në artikullin 600 (paga) 13 milionë lekë
- Në artikullin 601 (Sigurime shoqërore e shëndetësore të paguara nga punëdhësi) 1 milionë lekë.

Me Aktin Normativ nr.28, datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin 2020”, të ndryshuar, për mbulimin e efektit financiar të shtesës së numrit të punonjësve referuar organikës së re të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është aprovuar shtesa në zërin 600 (paga) në **shumën 10 milionë lekë**.


Situata e realizimit të fondeve vijon në tregues të ulët në të gjithë zërat e shpenzimeve, e veçanërisht në zërat “Mallra e shërbime” dhe “Investime”, e cila sipas komunikimeve me sektorin e shërbimeve,

ka si shkak kryesor faktin e vonesave në sigurimin e mjediseve të punës për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit, duke sjellë bllokimin e punës për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të parashikuar në regjistrin e parashikimeve të vitit 2020.

Sipas informacionit të shpenzimeve të kryera deri në dt.24.07.2020, realizimi në vlerë dhe në % i buxhetit për çdo zë për periudhën janar - korrik 2020, është detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Art.	Përshkrimi	PLANI VJETOR (I rishikuar)	FAKTI deri në dt.24.07.2020	Realizimi në %
600	Paga personeli	74,300,000	8,178,210	11 %
601	Sigurime shoqërore e shëndetësore	5,900,000	1,033,476	12.7%
602	Shpenzime operative	9,000,000	563,086	6.3%
231	Investime – blerje pajisje zyre	960,000	-	-
231	Investime – blerje pajisje informatike	6,040,000	-	-
	TOTALI	96,200,000	9,774,772	10.2%



Me Vendimin nr.577, datë 22.07.2020 të Këshillit të Ministrave, janë miratuar dhe tavanet e shpenzimeve të PBA 2021-2023, ku për Institucionin e ILD-së janë parashikuar fonde për shpenzime operative dhe investime në masën 195,000,000 lekë.

Nga krahasimi i parashikimeve të institucionit për fonde, kundrejt taveve të miratuara, rezulton një diferencë e konsiderueshme ç'ka do të përbënte një risk me impakt negative në arritjen e objektivave dhe qëllimeve strategjike të ILD-së.

Sjellim në vëmendje tuaj se ILD është një institucion i krijuar rishtazi, i cili e ka të nevojshëm mbështetjen në aspektin financiar me qëllim ushtrimin normal të veprimtarisë dhe funksioneve të tij të parashikuar nga Kushtetuta e Republikës dhe legjislacioni në fuqi.

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 507, datë 24.06.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë të godinës së ish- Ministrisë së Integritimit Evropian”, ka miratuar mjediset e punës së ILD-së të cilat kërkojnë fonde të konsiderueshme për t’u rikonstruktuar dhe për t’u vënë në kushte pune, pa llogaritur këtu edhe pajisjen e zyrave me mjetet e punës. Është për t’u theksuar se ky vendim nuk ka gjetur akoma zbatim.

Sa më sipër, për shmangien e këtij risku me pasoja tepër serioze në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është krijuar institucioni i ILD-së, po i kërkohet Këshillit të Ministrave rishikim i taveve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 për ILD.

7. BASHKËPUNIME ME INSTITUCIONE TË TJERA APO MEKANIZMA NDËRKOMBËTARË

Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, bashkëpunimi ndërinstytucional me këshillat, gjyqësor dhe të prokurorisë, por dhe me këshillat e gjykatave dhe jo vetëm, ka një rol të pazëvendësueshëm në drejtimin, garantimin dhe mirëfunksionimin e institucionit.

Me këtë fokus është punuar në këto drejtime:

➤ Bashkëpunimi i ILD-së me KLGJ-në dhe KLP-në:

Sipas parashikimeve të pjesës V dhe dispozitave kalimtare të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Inspektorati i KLD-së ka qenë struktura kompetente për të hetuar shkeljet disiplinore të të gjithë gjyqtareve dhe inspektoreve, deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në kuadër të ndryshimeve ligjore kur parashikohej krijimi i ILD-së, ankesat ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve janë depozituar pranë KLGJ-së, me qëllimin për t'i kaluar Zyrës së ILD-së sapo të krijohej. Me krijimin e ILD-së depozitimi i këtyre ankesave është në proces e sipër.

Me ngritjen e ILD-së, nga KLGJ është caktuar me detyrën inspektore magjistrate zonja Marsela Pepi, ndërsa nga KLP magjistrate Mirela Kapo në pozicionin e ndihmës magjistratit (këshilltar).

➤ **Bashkëpunimi i ILD-së me institucione të tjera dhe me partnerët ndërkombëtar:**

Sa i përket partnerëve ndërkombëtarë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani ka marrë mbështetje për punën e tij në takimet që ka pasur me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zj. Yuri Kim dhe Ambasadorin e Bashkimit Evropian, z. Luigi Soreca, me ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë, z. Peter Zingraf dhe me Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri, znj. Guusje Korthals Altes.

Gjithashtu Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar një takim online me ambasadorin e OSBE në Shqipëri, z. Bernd Borchardt, me focus një bashkëpunim konkret, një system elektronik të menaxhimit të ankesave, që OSBE do i vendosë në dispozicion ILD-së e që do të rrisë kapacitetet e punës së inspektorëve të Zyrës së ILD-së për ankesat e qytetarëve apo institucioneve.

Ky sistem ankesash elektronike është zhvilluar e testuar nga OSBE e EURALIUS ne vitet 2017-2018.

Gjithashtu, ILD ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me EURALIUS për ngritjen dhe funksionimin e veprimtarisë së institucionit.

➤ **Bashkëpunimi i ILD-së me institucionet qëndrore:**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka pasur bashkëpunim me Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë për sa i përket krijimit të kushteve të domosdoshme infrastrukturore dhe miratimit të strukturës për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

Këshilli i Ministrave ka miratuar mjediset e punës së ILD-së me vendimin nr. 507, datë 24.06.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë të godinës së ish- Ministrisë së Integritimit Evropian”.

Ndërsa Kuvendi i Shqipërisë, ka kontribuar në lehtësimin e punës së Inspektorit të Lartë me miratimin e strukturës organizative si dhe duke ju përgjigjur pozitivisht kërkesës së nisur nga Inspektori i Lartë

për pasjen e një ambjenti pune në këtë institucion, përkohësisht, me qëllim përfundimin e procedurave të rekrutimit.

8. KONKLUZIONE

Bazuar në të gjithë veprimtarinë dhe punën e kryer deri tani konstatohet se në funksion të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese, veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është fokusuar fillimisht në organizmin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit si në aspektin administrativ ashtu edhe atë rregullator. Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën Shkurt - Korrik 2020, në kuadër të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, programimit dhe zbatimit të buxhetit, procesit të prokurimit, kontabilitetit, raportimit financiar dhe atij të pagesave, si dhe infrastrukturës së institucionit apo sistemit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ka miratuar 22 urdhra dhe 8 vendime.

Në të njëjtën kohë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor dhe nisjen e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve krahas hartimit të akteve të nevojshme nënligjore është në proces administrimi dhe shqyrtimi fillestar të një numri të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve. Këto ankesa janë dorëzuar gjatë periudhës transitore 2017-2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Prokurorisë së Përgjithshme. ILD gjithashtu nga data 01.02.2020, datë në të cilën konsiderohet fillimi i veprimtarisë së tij, po administron të gjitha ankesat e paraqitura pranë tij nga ana e personave fizik ose juridik.

Gjatë periudhës kohore Shkurt - Korrik 2020 pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë depozituar rreth 1339 ankesa, ku për 1275 ankesa pas përpunimit të informacionit fillestar është konfirmuar administrimi dhe trajtimi i tyre; janë miratuar 88 vendime për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar/verifikimit; janë miratuar 6 vendime për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve; si dhe është nisur procedimi disiplinor për 2 magjistratë.

Gjatë kësaj periudhe, prioritet i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë edhe shqyrtimi dhe vlerësimi me seriozitet i të gjitha çështjeve të cilat kanë pasur një impakt publik. Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka iniciuar kryerjen e një inspektimi tematik pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit, si dhe të zyrave të prokurorive pranë tyre, mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht” për periudhën kohore 01.01.2017 - 31.01.2020.

Ecuria e veprimtarisë së Zyrës së ILD-së është ngadalësuar për shkak se institucioni është hasur me mungesën ambienteve të nevojshme për ushtrimin e punës, buxhetit financiar të kufizuar të vënë në dispozicion, si dhe të burimeve njerëzore. Si pasojë e pandemisë botërore COVID-19, gjatë kësaj periudhe nuk është bërë i mundur sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të këtij institucioni, si dhe janë pezulluar procedurat e rekrutimit të nëpunësve civil, të inspektorëve jomagjistratë apo dhe atyre magjistratë. Aktualisht nga ana e Këshillave janë komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm dy magjistratë, si dhe konstatohet një mungesë interesi nga ana e magjistratëve për t'u komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në të njëjtën kohë, pezullimi i veprimtarisë së gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore, ka ndikuar në krijimin e vonesave apo në mosveprime në ushtrimin e detyrave nga ana e tyre.

Për sa më sipër, paraprakisht vlerësohet se Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pavarësisht sfidave të hasura që në fillimin e punës së tij, ka nisur tashmë përmbushjen e një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve ligjore, të cilat do të finalizohen gjatë gjatë muajit të dytë të vitit 2020.


Veprimtaria e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës në vazhdim do ketë si objektiv kryesor ushtrimin veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficiente, profesionale, si dhe sa më transparente dhe të besueshëm ndaj publikut. Në të njëjtën kohë, do të synohet rritja e standardeve me qëllim zhvillimin e procesit hetimor disiplinor në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe standardet ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i një pjesëmarrje aktive të Zyrës së I.L.D-së në proceset e planifikimit strategjik dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Menaxhimi dhe zhvillimi i veprimtarisë së këtij institucioni të ri kushtetues do të realizohet gjatë periudhës në vazhdim nëpërmjet një qasje ndërsektoriale, si dhe nëpërmjet sigurimit të një sërë mekanizmave të përshtatshëm të qeverisjes, monitorimit, raportimit, metodave dhe treguesve të mirëpërcaktuar, së bashku me mbështetjen e duhur financiare për zbatimin e tyre. Për këtë qëllim nga ana e stafit të Zyrës së ILD po punohet për hartimin e një Plani Strategjik, i cili do të shërbejë si një udhërrëfyes i nevojshëm për menaxhimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

ANEKSI 1

	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK
Ankesa nga qytetarët	147	68	12	87	89	39
Ankesa nga KLGJ (të prapambetura)	-	-	-	82	534	141
Ankesa nga Institucione te tjera	61	9	7	25	23	15
Konfirmime qytetarëve	147	68	12	87	89	39
Vendime mbi verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar	1	1	2	3	9	1
Vendime mbi arkivimin e ankesave	8	-	-	7	18	-
Kërkesa drejtuar institucioneve për kërkesë informacioni	2	2	4	6	15	-
Njoftime mbi vendimet e arkivimit	8	-	-	7	18	-
Hetime disiplinore (vendim pezullimi dhe mbyllje të hetimeve)		-	1	2	5	
Inspektive tematike	1	-	-	-	-	-

ANEKSI 2



ORGANIKA E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PUNONJËS GJITHSEJ 93

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
INSPEKTORI I LARTË I		
1 DREJTËSISË	G3	1
<hr/>		
1.1 KABINETI		9
<hr/>		
KËSHILLTAR	Barazohet në pagë me Zëvendësministrin	7
NDIHMËS	III-a	1
SEKRETAR	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	1
2 NJËSIA E INSPEKTORËVE		28
<hr/>		
INSPEKTORË MAGJISTRATË	G2	14
INSPEKTORË JOMAGJISTRATË	I-b	14
3 SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
<hr/>		
4 NJËSIA E NDIHMËSINSPEKTORËVE		18
<hr/>		

	NDIHMËSINSPEKTORË	II-b	18
5	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE		13
	DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-a 1	
5.1	DREJTORIA E ANALIZËS LIGJORE DHE HARTIMIT TË AKTEVE		5
	DREJTOR	II-b	1
5.1.1	SEKTORI I HARTIMIT TË AKTEVE DHE PËRPUTHSHMËRISË		2
	SPECIALIST	III-b	2
5.1.2	SEKTORI I STUDIMEVE JURIDIKE DHE ANALIZËS LIGJORE		2
	SPECIALIST	III-b	2
5.2	DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE		7
	DREJTOR	II-b	1
5.2.1	SEKTORI I PËRFAQËSIMIT DHE RAPORTIMEVE		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
5.2.2	SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
6	DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		20

	DREJTOR	II-b	1
6.1	SETORI I BUXHETIT DHE FINANCËS		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI III-a 1		
	SPECIALIST III-b 2		
6.2	SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV PROTOKOLLIT		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST (BURIME NJERËZORE) SPECIALIST	III-b	1
	(REDAKTOR/ARKIV/PROTOKOLL)	III-b	1
6.3	SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
6.4	SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME		9
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST (SHËRBIME DHE PROKURIME)	III-b	1
	NËPUNËS INFORMACIONI		1
	SHOFER		4
	MAGAZINIER		1
	PUNONJËS PASTRIMI		1
7	SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENSHËM		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI III-a 1		
	SPECIALIST III-b 2		